



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Europrint Group” Sh.P.K. të datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP – Dollap metalik” me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Europrint Group” Sh.P.K. të datës 15.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP – Dollap metalik” me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Europrint Group” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Europrint Group” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 15.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP – Dollap metalik” me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “ju si AK keni kerkuar sqarime shtese dhe ne me daten 29.04.2024 ju kemi derguar sqarime dhe ne deklarate ju kemi treguqe qe ISO OHSAS

18001 është zavedesuar me me ISO 45001 dhe kjo ISO është e bashkanegjitur ne deklaratën që jau kemi derguar”.

Lidhur me pretendimin ankimor duhet sqaruar se ky pretendim ndërlidhet me arsyen e eliminimit sipas njoftimit mbi vendimin të formuluar si vijon:

OE EUROPRINT GROUP SH.P.K., Kompleksi Banesor A1 Lagja Emshir edhe pas sqarimeve të kërkuara nga ana e AK-së të datës 29.04.2024 nuk ka arritur të sjell Certifikatën OHSAS 18001

Fillimisht duhet cekur se nuk është kontestues as për parashtruesin fakti që në dosjen e tenderit është kërkuar të dorëzohet certifikata OHSAS 18001. Ngjashëm sikurse nuk është kontestuese që parashtruesi i janë kërkuar sqarime shtesë dhe as pas sqarimeve shtesë nuk është dorëzuar certifikata e kërkuar sipas dosjes së tenderit.

Nga një kërkim i thjeshtë në burimet e hapura në internet mund të kuptohet se certifikatat OHSAS 18001 dhe ISO 45001, në fakt janë pjesë të një familje mirëpo janë dy certifikata të ndryshme me dallime esenciale mes tyre.



Solutions + Industries + Resources + About + News Events

One of the biggest differences you'll notice between OHSAS 18001 and ISO 45001 is how the standard is structured. The structure of ISO 45001 is based on the Annex SL framework. You might already be familiar with the Annex SL format if your organization follows other ISO standards, like [ISO 14001](#) and ISO 9001. Having a common structure makes implementing multiple standards within one organization easier.

2. Hazard identification

ISO 45001 also places a greater emphasis on risk management. Unlike OHSAS 18001, which only focused on controlling known hazards, ISO 45001 requires organizations to proactively identify sources or situations that have the potential to cause harm. It's part of a bigger shift we're seeing toward risk management being baked into a company's operations at every level.

Risk assessments, audits, JSAs will be especially important under the new standard. Companies will need to consider and address risk and opportunities related to routine and non-routine situations, emergencies, changes to operations or processes, and even the management system itself.

Shih: <https://www.lisam.com/news/the-difference-between-ohsas-18001-and-iso-45001/#:~:text=Unlike%20OHSAS%2018001%2C%20which%20only,company's%20operations%20at%20every%20level>

Vlen të shtohet po ashtu se shumica e tenderuesve në këtë aktivitet të prokurimit kanë dorëzuar certifikatë valide OHSAS 18001 që dëshmon se kjo certifikatë është ende si valide në treg dhe kërkesa në fjalë është në përputhje të plotë me nenin 7 et. al. të LPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.05.2024


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.